



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:298630

Datë: 12.05.2021

Numri i dokumentit: 01776814

C.nr.1573/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Misin Frangu, me bashkëpunëtorin profesional Vjosa Hasani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve: L.K me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, L.G me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, S.S me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, Sh.S me vendbanim në Gjilan dhe I.R me vendbanim në fsh. "...” Komuna Lipjan, që të gjithë me autorizim i përfaqëson Qendrim Reçica avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson Lulzim Muharremi jurist i diplomuar nga Shqimja, në çështjen juridike për pagesën e ushqimit nga marrëdhënia e punës, udhëtimit, si dhe shpërblimit jubilar, në seancën e mbajtur me datë 15.40.2021, kurse më datë 10.05.2020 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve: L.K me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, L.G me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, S.S me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, Sh.S me vendbanim në Gjilan dhe I.R me vendbanim në fsh. "...” Komuna Lipjan, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, që paditësve: L.K me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, L.G me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, S.S me vendbanim në fsh. "...” Komuna Shtime, Sh.S me vendbanim në Gjilan dhe I.R me vendbanim në fsh. "...” Komuna Lipjan, në emër të shpenzimeve të ushqimit nga marrëdhënia e punës, udhëtimit, si dhe shpërblimit jubilar, t’ua paguaj shumat si në vijim:

1.Paditëses L.K ne emër te shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ua paguaj 50 % të një page bazë shumen prej 224.67 €, në emër te shpenzimeve te ushqimit për 541 ditë shumën prej 1,082 € dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 541 ditë shumën prej 378.70 € gjithsejte shumen prej 1,685.37 €.

2.Paditësit L.G në emër te shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ua paguaj 50 % të një page bazë shumen prej 147.35 €, në emër të shpenzimeve te ushqimit për 386 ditë shumën prej 772.00 € dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 386 ditë shumën prej 270.20 €, gjithsejte shumen prej 1,189.55 €.

3.Paditëses S.S në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune t'ua paguaj 75 %, të një page bazë shumen prej 331.50 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 541 ditë shumën prej 1,082.00 €, dhe ne emër te shpenzimeve te udhëtimit për 541 ditë shumën prej 378.70 €, gjithsejte shumen prej 1,792.20 €.

4.Paditësen Sh.S në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune t'ua paguaj 100 %, të një page bazë shumen prej 442.00 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 541 ditë shumën prej 1,082.00 €, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 541 ditë shumën prej 1,514.80 €, gjithsejte shumen prej 3,038.08 €.

5.Paditësit I.R në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ua paguaj 50 %, të një page bazë shumen prej 200.77 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 636 ditë shumën prej 1,272.00 €, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 636 ditë shumën prej 890.40 €, gjithsejte shumen prej 2,363.17 €. Të gjitha këto shume te paguhen ne kamat ligjore 8 % nga dita e ushtrimit te padis deri ne pagesën definitive.i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore në shumen prej 21.00 €, për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 €, për një seancë shumën prej 811.20 €.

III. OBLIGOHET e paditura që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore në shumen prej 21.00 €, për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 €, për një seancë shumën prej 811.20 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

IV. DETYROHEN paditësit që paraprakisht të bëjnë pagesën e taksës gjyqësore shtesë në shumë prej 80.00 €, menjëherë pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre kanë ushtruar padi pran kësaj gjykate me datë 30.12.20219, kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtorisë së Arsimit, me bazë juridike për pagesën e ushqimit nga marrëdhënia e punës, udhëtimit, si dhe shpërblimit jubilar.

I autorizuari i paditësve gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të dorëzuar më datë 30.12.2019 dhe precizimit të padisë gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga gjykata t'ia aprovoj kërkesëpadinë e paditësve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit ditor dhe për udhëtim si dhe për shpërblimin jubilar dhe të detyrohet e paditura që për paditësit:

1.Paditëses L.K në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ua paguaj 50 % të një page bazë shumen prej 224.67 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 541 ditë shumën prej 1,082 € dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 541 ditë shumën prej 378.70 € gjithsejte shumen prej 1,685.37 €.

2.Paditësit L.G në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ua paguaj 50% të një page bazë shumen prej 147.35 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 386 ditë shumën prej 772.00 € dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 386 ditë shumën prej 270.20 €, gjithsejte shumen prej 1,189.55 €.

3.Paditëses S.S në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune t'ua paguaj 75 %, të një page bazë shumen prej 331.50 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 541 ditë shumën prej 1,082.00 €, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 541 ditë shumën prej 378.70 €, gjithsejte shumen prej 1,792.20 €.

4.Paditësen Sh.S në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune t'ua paguaj 100 %, të një page bazë shumen prej 442.00 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 541 ditë shumën prej 1,082.00 €, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 541 ditë shumën prej 1,514.80 €, gjithsejte shumen prej 3,038.08 €.

5.Paditësit I.R në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune t'ua paguaj 50%, të një page bazë shumen prej 200.77 €, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 636 ditë shumën prej 1,272.00 €, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 636 ditë shumën prej 890.40 €, gjithsejte shumen prej 2,363.17 €. Të gjitha këto shume te paguhen ne kamat ligjore 8 % nga dita e ushtrimit te padis deri ne pagesën definitive. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore në shumen prej 21.00 €, për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 €, për një seancë shumën prej 811.20 €.

I autorizuari i paditurës gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjeje në padi, duke shtuar nuk i kundërshton provat e dorëzuar nga paditësit për arsyeje se janë marrë nga personat kompetent të cilat punojnë në shkolla përkatëse. Por e ka kundërshtuar bazën ligjore të kësaj kërkesëpadie, pasi që Komunitat nuk janë nënshkruese të kontratës kolektive dhe nënshkrues e kësaj kontakte është Qeveria e Republikës së Kosovës. Përfaqësuesi i të paditurës ka vazhduar me deklarinimin e tij se nënshkruesit e kontratës kolektive janë zotuar se do ti ndihmojnë Komunitat me buxhet shtese për ti përmbushur këto detyrime që rrjedhin nga kontratat kolektive por ata asnjëherë nuk e kane përmbushur këtë zotim, ka vazhduar se Komuna e Shtimes si Komunë e vogël nuk ka buxhet të mjaftueshëm për ti përmbushur këto detyrime që rrjedhin nga kontratat kolektive dhe për këtë nuk ka mund të ndaj vije buxhetore. E ka Kundërshtuar propozimin e përfaqësuesit të paditëseve që kamata ligjore të rrjedh nga dita e parashtrimit të padisë, i ka propozuar gjykatës që kamata ligjore të rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit për këto arsyeje i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzon ne tersi si të pabazuar.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse parashtruan ato, si obligim i tyre sipas nenit 7 par.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si në vijim: kontrata e punës ne emër të L.K kontrata e punës ne emër të L.G kontrata e punës ne emër të S.S kontrata e punës ne emër të Sh.S kontrata e punës ne emër të I.R vërtetimi me numër protokolli "... " i datë 26.06.2020 ne emër te L.K lëshuar nga gjimnazi "... " Komuna e Shtimes, vërtetimi me numër protokolli "... " i datës 03.07.2020 në emër të L.G lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë "... " Komuna e Shtimes, vërtetimi me numër protokolli "... " i datë 02.07.2020 në emër të L.G lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë "... " fshati "... " -Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër

protokolli "...” i datë 02.07.2020 në emër të L.G lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ultë "...” fshati "...” Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 26.06.2020 ne emër te S.S lëshuar nga gjimnazi "...” Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 26.06.2020 ne emër te Sh.S lëshuar nga gjimnazi "...” Komuna e Shtimes, Vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 26.06.2020 ne emër te I.R lëshuar nga gjimnazi "...” Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 03.04.2018 ne emër te L.K lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulte "...” -Komuna e Shtimes, vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 10.06.2010 në emër të L.K lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ulte "...” Komuna e Malisheve, vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 06.09.2010 ne emër te L.K lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ulte "...” fshati "...” Komuna e Malishevës, vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 21.11.2019 ne emër te L.G lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë "...” fshati "...” Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 10.09.2019 ne emër te L.G lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ultë "...” Komuna e Shtimes, vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 25.11.2019 ne emër te L.G lëshuar nga gjimnazi "...” -Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 27.11.2019 në emër të L.G lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ultë "...” FSH. "...” Komuna e Shtimes. vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 19.11.2012 në emër të L.G lëshuar nga shkolla fillore dhe e mesme e ultë "...” fshati "...” Komuna e Shtimes, vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 16.04.2003 në emër të S.S lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë "...” Komuna e Ferizaj, vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 16.04.2003 në emër të Se.S lëshuar nga shkolla e mesme "...” Komuna e Kaçanik, vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 07.11.2019 në emër të Sh.S lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë "...” Komuna e Ferizaj, vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 08.11.2019 në emër të Sh.N lëshuar nga Shkolla e Mesme "...” Komuna e Ferizaj, vërtetimi me numër protokoli "...” i datës 01.06.2015 në emër të I.R lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë "...” fshati "...” Komuna Shtime, vërtetimi me numër protokoli "...” i datë 07.11.2019 në emër të I.R lëshuar nga shkolla gjimnazi "...” -Shtime.

I autorizuari i paditësve dhe i autorizuari i të paditurës nuk i kanë kundërshtuar provat e propozuar nga paditësit dhe të administruar në shqyrtimin kryesor.

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi

bazën e bindjes së lirë të krijuar nga shqyrtimi i provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që, për të paditurën, nuk ishin kontestuese provat e paraqitura në këtë procedurë, por baza juridike dhe lartësia e saj, me qëllim të përcaktimit se kush është e obliguar të mbuloj kompensimet e cekura si në kërkesëpadi, gjykata ka analizuar dispozitat e Kontratës Kolektive në Arsim e datë 18.04.2017.

Sipas nenit 35 pika 5 e Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.***

Sipas nenit 35 pika 7 e Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.”***

Sipas nenit 35 pika 8 e Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës në vlerë prej 50% të një page bazë; për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75% të një page bazë; për 30 vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë; për 40 vite të përvojës së punës në vlerë prej 150% të një page bazë...”***

Sipas nenit 46 të Kontratës Kolektive në Arsim, e vitit 2017, parashihet që: ***“MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9”.***

Gjykata nga analizimi i dispozitave të cituar si më lartë, ka ardhur në përfundim se e paditura është e obliguar që paditësve t’ua paguaj shpenzimet e ushqimit, udhëtimit dhe pagesën e shpërblimit jubilar, konform dispozitave të Kontratës Kolektive në Arsim e vitit 2017, të elaboruara si më lartë.

Sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se nuk ekziston mundësia financiare sepse e paditura nuk ka pranuar ndihmë financiare nga Ministria e Financa për zbatimin e Kontratës Kolektive, si dhe nuk kanë udhëzim administrativ nga Qeveria e Kosovës si nënshkruese e Kontratës së Përgjithshme kolektive se si të veprohet me implikimet financiare të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive Komuna e Shtimes nuk ka nda buxhet dhe nuk ka vijë buxhetore për mbulimin e kësaj kategorie dhe në mungesë të buxhetit edhe nuk mund të bëjë pagesën jubilarë dhe shpërblimin jubilar si dhe për kompensimin për ushqim dhe shpenzimet e udhëtimit 70%, të lartësisë së biletës të cilën e kukojnë paditësit sipas kontratës kolektive e deri më tani institucionet publik nuk bënë pagesën e shpenzimeve të udhëtimit kurse kompensimin për shujtat ushqimore e bëjnë vetëm disa institucione të posaçme siç janë FSK, Burgjet etj, për gjykatën është pretendim i pabazuar sepse e paditura është e obliguar drejtpërdrejtë që ta zbatojë këtë Kontratë Kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin dhe të siguroj mjete financiare për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kontrata në fjalë, e jo të thirret se nuk ka mundësi financiare për të përmbushur obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive.

Gjykata nga kontratat e punës vërtetoi faktin se të gjithë paditësit janë të punësuar tek e paditura, ndërsa nga vërtetimi i punës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi L.K ka përvojë pune tek e paditura mbi 10 vite, paditësi L.G ka përvojë pune mbi 10 vite, S.S ka përvojë pune tek e paditura mbi 20 vite, Sh.S ka përvojë pune mbi 30 36, si dhe I.R ka përvojë pune mbi 10 vite.

Bazuar në provat e administruara në këtë procedurë, përvojën e përgjithshme të punës të secilit paditës, ditët e punës të secilit paditës të kaluara tek e paditura, si dhe bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e bazuar si për nga baza juridike, ashtu edhe për nga lartësia e saj, andaj si të tillë e ka aprovuar në tërësi si të themeltë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata duke u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës për taksë gjyqësore në shumen prej 21.00 €, për përpilimin e padisë shumen prej 624.00 €, dhe për një seancë shumën prej 811.20 €.

Andaj, nga arsyet e lartë cekura, konform nenit 143 të LPK-së, lidhur me nenin 35 pika 5, 7 dhe 8, si dhe nenin 46 të Kontratës Kolektive për Arsim Parauniversitar e vitit 2017 dhe nenit 382 par.2 i LMD-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Bazuar në nenin 12.4 të UA nr.1/2017 të KGJK-së, paditësit janë obliguar që të paguajnë taksën gjyqësore shtesë në shumë prej 80.00 €.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.1598/19 me datë 10.05.2021

Gjyqtari
Misin Frangu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.